



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC

**SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE
NGRITJE NË DETYRË
NË KATEGORINË E ULËT DREJTUESE**

“Pergjegjes i Sektorit te Lejeve te Ndertimit”

Në zbatim të nenit 26, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe të Kreut II dhe III, të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Bashkia Roskovec shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë për pozicionin:

Pergjegjes i Sektorit te Lejeve te Ndertimit , Klasifikuar - Kategoria:III-a

Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

**PËR TË DY PROCEDURAT (LËVIZJE PARALELE, NGRITJE NË DETYRË)
APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË!**

20 PRILL 2018

**Afati për dorëzimin e dokumentave për:
LËVIZJE PARALELE**

25 PRILL 2018

**Afati për dorëzimin e dokumentave për:
NGRITJE NË DETYRË**

DETYRAT KRYESORE

- harton dokumentin e politikës së zhvillimit të territorit të njësisë së qeverisjes vendore që përbehet nga dokumenti i politikës së zhvillimit të territorit dhe shtojca e hartave
- harton dokumentin e analizës dhe vlerësimit të gjendjes ekzistuese territoriale e mjedisore në territorin e njësisë së qeverisjes vendore i cili shoqërohet me paraqitjen grafike
- harton planin e propozuar për përdorimin e tokës
- harton planin e propozuar të shërbimeve dhe infrastrukturave publike
- harton dokumentin për prezantimin e planit të përgjithshëm vendor në keshillin bashkiak
- merr pjesë në hartimin e rregullores vendore të planifikimit.
- merr pjesë në procesin e shqyrtimit të kërkesës së lejeve të punimeve nga kkt në fazën e vlerësimit të përmbushjes së formës duke hartuar një raport ku shprehet vlerësimi nëse për këtë kërkesë nevojitet plan i detajuar vendor ose jo dhe raporti i përcillet akpt
- siguron dhe monitoron respektimin e afatëve ligjore të përcaktuara në shqyrtimin e aplikimeve për ushtrim aktiviteti dhe kthimin e përgjigjeve brenda afatëve;
- vlerëson dhe kontrollon dokumentacionin ligjor që shoqëron aplikimin dhe jep me shkrim vlerësimin
- vlerëson kërkesat dhe dokumentacionin teknik e juridik për leje punimesh, të individëve dhe subjekteve shtetërore e private, të interesuar;
- vlerëson dhe kontrollon dokumentacionin teknik, që shoqëron aplikimin dhe jep me shkrim vlerësimin për të gjitha shqyrtimet e aplikimeve për leje punimesh dhe jep sugjerime për zgjidhje në kohë sa më të shkurtër, nëse ka probleme;
- vlerëson informacionin e nevojshëm për zonën që kërkohet të zhvillohet dhe instrumentet e nevojshëm të planifikimit, planin e përgjithshëm vendor, planin e detajuar vendor, dhe bën përputhshmërinë e kërkesës për leje punimesh, me instrumentat e planifikimit të territorit dhe rregulloret përkatëse;
- verifikon kërkesat e ankesat e ardhura në adresë të sektorit dhe përgatit përgjigjet për këto probleme si dhe identifikon problematikat e rezultuara gjatë procesit të shqyrtimit të aplikimeve dhe harton brenda afatëve të përcaktuara njoftimet zyrtare për aplikuesit.
- planifikon, menaxhon dhe organizon punën e sektorit në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore, në marrjen në shqyrtim të dosjes për fillimin e procedurave për shpronësim të individëve apo subjekteve private si dhe kryerjen e identifikimit të personave apo subjekteve që do preken nga shpronësimet dhe njofton të interesuarit për shpronësim;
- ndjek procedurat administrative dhe ligjore të identifikimit të sipërfaqeve të prekura të pasurive pronë private, truall apo objekt, që do të shpronësohet nga realizimi i projekteve publike duke verifikuar situatën në terren dhe duke monitoruar procesin e matjeve dhe azhurnimin e objekteve apo sipërfaqeve të trojeve, që do të preken nga shpronësimet;
- monitoron verifikimin dhe përgatitjen e dokumentacionit të plotë teknik/juridik të domosdoshëm për plotësimin e dosjes/kërkesës së shpronësimit, konform legjislacionit në fuqi;

- ndjek dhe monitoron procesin e llogaritjeve paraprake të vlerës së shpronësimit, sipas vkm-ve në fuqi për truallin dhe çmimin e konfirmuar nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për objektet, bazuar në zonën ku do të realizohet projekti publik i miratuar;
- siguron një sistem të shëndoshë të kontrollit të brendshëm për përgatitjen e administrimit teknik të procedurave të shpronësimit të individëve apo subjekteve private si dhe kryerjen e identifikimit të personave apo subjekteve që do preken nga shpronësimet nëpërmjet dokumentacionit të plotë teknik/juridik sipas kërkesave të eprorit, duke iu përmbajtur objektivave dhe afateve të përcaktuara me synim arritjen e rezultateve në punë;
- sugjeron dhe monitoron përgatitjen e materialeve të duhura informuese për drejtorinë në lidhje me përgatitjen e projektit teknik të shpronësimeve ku evidentohen sipërfaqet e pasurive të prekura pronë private, verifikim në terren (kur është e nevojshme) së bashku me specialistët për pasuri dhe objekte që do të preken nga zbatimi i projektit, duke vlerësuar të gjitha mundësitë proceduriale.

LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori III-a
- b- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" , Drejtesi, Inxhinieri, Arkitektur;
- b- Të kenë të paktën 3 vjet përvojë pune ne administraten shtetërore vendore.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a - Jetëshkrim
- b - Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g - Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;

- h - Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhen dorazi prane Njesise se Menaxhimit te Burimeve Njerezore

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave për lëvizjen paralele duhet të bëhet brenda datës: 20.05.2018

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **23.04.2018** Bashkia Roskovec do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e lëvizjes paralele, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga Njesia e Menaxhimit te Burimeve Njerezore për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

Kandidatet te cilet rezultojne te pakualifikuar brenda 3 (tre) diteve nga shpallja e listes paraprake te verifikimit te kandidateve, ne daten 26.04.2018 kane te drejte te paeaqesin ankesat e tyre ne njesine e menaxhimit te burimeve njerezor. Brenda 5 (pese) dite pune nga data e paraqitjes se ankeses me date 02.05.2018 njesia e menaxhimit te burimeve njerezore u kthen pergjigje kandidateve te pakualifikuar.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- Ligjin Nr.139/2015, date 17.12.2015 “Për veteqeverisjen vendore”.
- Ligjin Nr.152/2013, “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar.
- Ligjin Nr.9131, datë 08.09.2003 “Per rregullat e etikës në administratën publike”.
- Ligjin Nr.119/2014 te miratuar me date 18.09.2014 “Per te drejten e informimit”
- Ligjin Nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës se Shqiperise”;
- Ligjin Nr.107/2014 te miratuar me date 31.07.2014 “Per planifikimin e territorit” i ndryshuar
- Ligji Nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”
- Ligji Nr.8752, date 26.03.2001 ”Per krijimin dhe funksionimin e strukturave per mbrojtjen e tokes”
- VKM Nr. 965, datë 2.12.2015 “Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit, në rastet e emergjencave civile dhe krizave”.

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer. Totali i pikeve për këtë vlerësim është 40 pikë ,i ndare ne:

- 20 pike pervoja;
- 10 pike trajnime ose kualifikime te lidhur me fushen perkatese;
- 10 pike vlersimi ne pune ;

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

a - Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;

b - Eksperiencën e tyre të mëparshme;

c - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;

Totali i pikëve për këtë vlerësim është **60 pikë**.

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njesia e Menaxhimit të Burimeve Njerezore do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Njesia e Menaxhimit të Burimeve Njerezore, për rezultatet (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

2 NGRITJA NE DETYRE

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë. Këtë informacion do ta merrni në faqen zyrtare të Bashkisë Roskovec.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategori më e ulët), të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin e lirë.

2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë janë:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda kategorisë IV-a, IV-b;
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Drejtësi, Inxhinieri, Arkitekturë;
- b- Të kenë të paktën 3 vjet përvojë pune në administratën shtetërore vendore;

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a - Jetëshkrim
- b - Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g - Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h - Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhen dorazi pranë Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerezore brenda datës: **25.04.2018**

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **07.05.2018**, Njesia e Menaxhimit të Burimeve Njerezore do të shpallë në faqen zyrtare të Bashkisë dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e ngritjes në detyrë si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e ngritjes në detyrë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Njesia e Menaxhimit të Burimeve Njerezore, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

Brenda 5 diteve kalendarike nga data e shpalljes së listës së kandidatëve të pakualifikuar kanë të drejtë të paraqesin ankese pranë Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerezore deri me datë 14.05.2018. Ankuesi merr përgjigje brenda datës 21.05.2018

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË

Kandidatët do të testohen me shkrim me date 23.05.2018 në lidhje me:

- Ligjin Nr.139/2015, date 17.12.2015 “Për veteqeverisjen vendore”.
- Ligjin Nr.152/2013, “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar.
- Ligjin Nr.9131, datë 08.09.2003 “Per rregullat e etikës në administratën publike”.
- Ligjin Nr.119/2014 te miratuar me date 18.09.2014 “Per te drejten e informimit”
- Ligjin Nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës se Shqiperise”;
- Ligjin Nr.107/2014 te miratuar me date 31.07.2014 “Per planifikimin e territorit” i ndryshuar
- Ligji Nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”
- Ligji Nr.8752, date 26.03.2001 ”Per krijimin dhe funksionimin e strukturave per mbrojtjen e tokes”
- VKM Nr. 965, datë 2.12.2015 “Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit, në rastet e emergjencave civile dhe krizave”.
-

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

- Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- Dokumentacioni i dorezuar, deri ne 20 pike;
- Intervista e strukturuar me goje, deri 40 pike;

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Komisioni i Ngritjes ne detyre brenda 24 (njëzet e katër) orëve, pra më date **24.05.2018**

I ve ne dispozicion listen e fituesve, Njesise se Menaxhimit te Burimeve Njerezore. Kandidatet pavarsisht te drejtes per tu ankuar ne Gjykatën Administrative kane te drejte te bejne ankim me shkrim brenda 3 diteve kalendarike nga data e njoftimit individual per rezultatin e vleresimit. Ankuesi merr pergjigje brenda 5 ditevekalendarike nga data e perfundimit te afatit te ankimit.

Njesia e Menaxhimit te Burimeve Njerezore, brenda dates 04.06.2018 shpall fituesin.

Njoftimi do të bëhet:

- në faqen zyrtare të Bashkisë Roskovec
- ne stenden e informimit publik te Bashkise Roskovec.
- Sherbimin kombetar e punesimit

Per sqarime te metejshme mund te kontaktoni ne :
e-mail : *evisa.mustafaj@yahoo.com*

NJESIA E MENAXHIMIT TE BURIMEVE NJEREZORE

BASHKIA ROSKOVEC